

VENDIM
Nr. 379, datë 7.5.2015

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR. 11, DATË 14.1.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME PËR VITIN 2015, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”, TË NDRYSHUAR, DHE PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIN 2015, MIRATUAR PËR MINISTRINË E ZHVILLIMIT URBAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 11 e 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, dhe të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 11, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Në pikën 1, numri i punonjësve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet “... 1 518 veta ...”.

b) Në nënndarjen 20, “Ministria e Zhvillimit Urban”, të lidhjes nr. 1, bashkëlidhur vendimit, shtohet nënndarja, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ministrisë së Zhvillimit Urban, në buxhetin e miratuar për vitin 2015, në programin “Planifikimi urban dhe strehimi”, i shtohet fondi prej 38 000 000 (tridhjetë e tetë milionë) lekësh, në zërin “Shpenzime korente”, për mbulimin e shpenzimeve për pastrimin e bregdetit, për Agjencinë Kombëtare të Bregdetit.

3. Ky fond përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2015.

4. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministria e Zhvillimit Urban për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Emri i institucionit	Nr. i punonjësve	Emërtesa	Koha ditore	Periudha kohore
(20) Ministria e Zhvillimit Urban (Turizmit)	300			
Agjencia Kombëtare e Bregdetit	300	Punonjës pastrimi/mirëmbajtjeje	8 orë/ditë	15 maj - 15 shtator